



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada – Government


Ministria e Punëve të Brendshme – Ministarstvo Unutrašnjih Poslova
Ministry of Internal Affairs

Policia e Kosovës/Policija Kosova/Kosovo Police
Drejtoria e Përgjithshme e Policisë/
Generalna Policijska Direkcija/General Police Directorate



Drejtoria e Policisë në Bashkësi dhe Parandalim (DPS) dhe Drejtoria për Parandalim
në Komunikacionin Rrugor (DKRR)

NDËRGJEGJËSIMI NDAJ DËMTIMEVE TË PRONËS SHOQËRORE / PUBLIKE



PËRMBAJTJA

<i>FAQJA E PARË</i> -----	<i>1.</i>
<i>PËRMBAJTJA</i> -----	<i>2.</i>
<i>1. INFORMATA</i> -----	<i>3.</i>
<i>2. INFRASTRUKTURA LIGJORE</i> -----	<i>4.</i>
<i>3. QËLLIMI I PROJEKTIT</i> -----	<i>5.</i>
<i>4. METODOLOGJIA</i> -----	<i>5.</i>
<i>5. MËNYRA E REALIZIMIT TË AKTIVITETEVE</i> -----	<i>5.</i>
<i>6. MEDIAT</i> -----	<i>7.</i>
<i>7. MONITORIMI</i> -----	<i>8.</i>
<i>8. RAPORTIMI</i> -----	<i>8.</i>
<i>9. VLËRSIMI</i> -----	<i>8.</i>

1. INFORMATA

1. Dëmtimi apo shkatërrimi me dashje i pronës shoqërore, është një dukuri shqetësuese dhe mjaft e shfaqur në vendin tonë. Qytetarët nuk janë mjaft të informuar rreth masave ndëshkuese në raste se ata shkaktojnë ndonjë dëmtim me dashje apo aksidentalisht. Gjithashtu qytetarët, nuk janë të informuar se të gjitha investimet dhe mirëmbajta e hapësirave publike, objekteve shoqërore etj, ndërtohen investohen nga tatimet e qytetarëve:

1.1. Dëmtimet vjedhjet përgjatë shtrirjeve të infrastrukturës rrugore, kablllove të ndryshme instaluese, përfshirë ndriçimin publik, vjedhjet e kapakëve të pusetave, dëmtimet vjedhjet e rrethojave në auto udhë, dëmtimet e shenjave vertikale të trafikut, ngjyrosja e tyre humbja e porosisë për pjesëmarrësit në trafik, dëmtimet apo largimi i pahive elastike etj.

Shkatërrimi dhe vjedhja kryesisht bëhen për arsye ekonomike dhe sociale, por edhe për mungesë të kulturës dhe përgjegjësisë elementare. Është një krim që mund të rrezikojë jetën e pjesëmarrësve në trafik.

Në auto udhë janë paraqitur disa dukuri negative siç janë vjedhja e rrethojës së Autostradës e cila ka mundësuar hyrjen e kafshëve të ndryshme brenda rrethojës dhe si pasojë e kësaj janë rrezikuar pjesëmarrësit në komunikacion dhe kemi pasur disa aksidente të trafikut ku veturat janë përplasur me kafshë (qen endacak dhe kafshë të egra).

Veprimet e tilla jo ligjore paraqesin rrezik të madh për pjesëmarrësit në komunikacion në Autostradë.

1.2. Dëmtimet tek objektet kulturore, bibliotekë, objektet fetare, shtëpi shëndeti etj duke i dëmtuar rrethojat dhe shkrimet e mureve me grafitë të ndryshme etj.

1.3. Dëmtime e elementeve të ndryshme në sheshe, parqe pushimoret/ulëseve, tabelave të ndryshme informative, shporta mbeturinash ndriçim të parqeve, fushat sportive, rrethojave të fushave sportive, dëmtimin e tabelave të basketbollit, dëmtimet e lojërave për fëmijë, vjedhja e luleve apo te fidanëve etj.

- 1.4. Dëmtimi i pyjeve, prerja, nderzja e tyre nderzja e fushave etj. Zjarrvenjet e prerjet ilegale të pyjeve në Kosovë janë një dukuri mjaft e shprehur viteve të fundit. Sipërfaqe të mëdha me pyje janë dëmtuar e po dëmtohen pavarësisht faktit që pyjet publike në Kosovë janë resurse kombëtare dhe mbrohen me ligj. Shkatërrimi dhe vjedhja e pyjeve janë vepra penale për të cilat mund të jepen dënime edhe me burg.

Të gjitha këto paraqesin rrezik për qytetaret, ambientin, por për kryesit e këtyre veprimeve edhe kryerjen e një krimi qoftë me dashje apo nga pakujdesia.

2. INFRASTRUKTURA LIGJORE

A. LIGJI Nr. 05/L-088 PËR RREGULLAT E TRAFIKUT RRUGOR;

Neni 15

Elemente penguese në trafik

- 1) Në shenjën e trafikut ose në shtyllën e saj në të cilën është e vendosur shenja e trafikut ndalohet vendosja e çdo gjëje që nuk ka të bëjë me shenjën e trafikut.
- 2) Personave të paautorizuar iu ndalohet të vendosin, t'i largojnë, t'i ndërrojnë ose t'i dëmtojnë shenjat e trafikut, të pajisjeve të rrugëve dhe t'ua ndërrojnë domethënien e shenjave të trafikut.
- 3) Është i ndaluar largimi i paautorizuar i kapakëve të rrjetit të ujës-jellësit, të kanalizimeve apo të ngjashme.
- 4) Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej dyqind (200) deri në gjashtëqind (600) euro, personi fizik i cili vepron në kundërshtim me dispozitat e paragrafëve 1. ose 2. të këtij neni.
- 5) Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej njëmijë (1000) deri në dymijë (2000) euro, personi fizik i cili vepron në kundërshtim me dispozitat e paragrafit 3. të këtij neni.
- 6) Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej dymijë (2000) deri në gjashtëmijë (6000) euro, personi juridik ose institucioni në emër të të cilit dhe brenda autorizimeve të të cilit ka vepruar personi i përcaktuar në paragrafin 4. të këtij neni.

KODI PENAL I REPUBLIKËS SË KOSOVËS

B. VEPRAT PENALE KUNDËR MJEDISIT, KAFSHËVE, BIMËVE DHE OBJEKTEVE KULTURORE;

C. VEPRAT PENALE KUNDËR SIGURISË SË PËRGJITHSHME TË NJERËZVE DHE PASURISË.

3. QËLLIMI I PROJEKTIT

3.1. Ndërgjegjësimi i qytetareve për dëmtimet e pronës shoqërore/publike;

3.2. Ngritja e nivelit të sigurisë;

3.3. Ngritja e nivelit të bashkëpunimit me qytetar;

3.4. Identifikimi i dukurive negative nga ana e qytetarëve -raportimi;

3.5. Inicimi i rastit për dëmtimin e Pronës shoqërore nga Policia dhe raportimi në institucionet përkatëse.

4. METODOLOGJIA

4.1. **ku:** projekti do të implementohet në të gjitha Drejtoritë Rajonale të Policisë në: Prishtinë, Pejë, Prizren, Gjakovë, Gjilan, Ferizaj, Mitrovicë-Jugu dhe Mitrovicë-Veri respektivisht në tërë territorin e vendit .

4.2. **kur:** aktivitetet nga projekti do të implementohen gjatë muajve vitit: Qershor Korrik, Gusht, Shtator dhe Tetor dhe duhet të aplikohet nga çdo stacion policor duke bashkëpunuar edhe me njësitet e hetimeve dhe të trafikut dhe njësit tjera adekuate.

4.3. **çka:** aktivitete të ndryshme ligjërata do të realizohen përmes takimit me qytetar, zyrtar të Komunës, të Ministrisë së Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI), KLSP, EVSP etj.

5. MËNYRA E REALIZIMIT TË AKTIVITETEVE DHE PËRSHKRIMI I PËRGJEGJËSIVE

5.1 Drejtoria e Policimit në Bashkësi dhe Parandalim (Sektori për Bashkëpunim me Forumet e Sigurisë), në bashkëpunim me Drejtorin për Parandalim në komunikacionin Rrugor (Sektori për Bashkëpunim dhe Përkrahje në Komunikacionin Rrugor) janë iniciues të projektit dhe përgjegjës për monitorimin e aktiviteteve që ndërlihen me të;

- 5.2. DRP-t obligohen të hartojnë planet e veprimit sipas udhëzimeve të këtij projekti dhe të koordinojnë të gjitha aktivitetet lidhur me këtë projekt;
- 5.3. Zyrtarë nga sektori për parandalim dhe zyrtar nga sektori për bashkëpunim me Forumet e Sigurisë të organizojnë takime me zyrtarë nga Ministria e Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, zyrtar Komunal, Infrakos agjencinë e pylltarisë duke i inkurajuar për bashkëpunim dhe raportim nga ana e tyre .
- 5.4. Të gjitha Stacionet Policore, respektivisht zyrtarët e angazhuar në sektorë, të mbajnë takime me anëtarët e KLSP-ve , nxënës, qytetar rreth rëndësisë së raportimit të dëmtimeve të pronave qoftë se ata i dëmtojnë aksidentalisht apo e shohin dikë tjetër që me dashje i dëmton apo shkakton rrezikim të ndryshëm.

5.5. PLANIFIKIMI I VEPRIMEVE OPERATIVE-TAKTIKE

Zyrtarët policor në nivel Stacioni Policor në bashkëpunim me strukturat komunale , me anëtarët e KLSP-ve dhe të EVSB-ve mundësisht të profesioneve nga lëmia e ambientit, shpëtim-kërkimit, agronomisë, shëndetit, mbrojtës nga zjarri, arsimimit dhe edukimit të organizuar në grupe të caktojnë terminë të kontaktit me të gjitha shtresat e qytetarëve siç janë: bujqit dhe nxënësit si fokus grupe me qëllim të edukimit dhe trajnimit në lidhje me identifikimin e shkaktarëve të zjarrit me pasoja të mëdha për rrezikshmërinë e përgjithshme shoqërore siç është jeta , shëndeti dhe prona publike e private.

5.5.1. Identifikimi i Partnerëve dhe Planifikimi i Veprimeve të përbashkëta

- Stacionet Policore dhe Nënstacionet Policore;
- Drejtoritë e Emergjencave dhe Njësit e Zjarrfikësve në Komuna.
- Drejtorit e Bujqësisë dhe Pylltarisë në Komuna.
- Drejtorit e inspektorëve komunal si janë :Inspektorët e ambientit shëndetësor dhe të trafikut në Komuna.
- Ekipet Vepruese, KLSP-të dhe KKSBB-të në nivele Komunale aty ku janë të themeluara dhe funksionale.
- Shoqëria Civile, Mediat dhe OJQ-ët në nivel Komunal.
- Drejtoritë e Arsimit dhe edukimit në nivele Komunale .

Me partnerët e identifikuar në nivel të Komunave që u cekën më lart të organizohen takime ku do të duhej të akordohen që secili të përcaktoj nga një përfaqësues i cili do të merrte përgjegjësit në bazë të kompetencave profesionale dhe ligjore të veprimeve vullnetare për të përcaktuar një Plan të Veprimit të përbashkët me qëllim të realizimit të këtij Projekti në zgjidhje të problemit: "DUKURIT NEGATIVE , EDUKIMI I KOMUNITETIT në PARANDALIM .

5.5.2. PLANI I VEPRIMIT

Java e tretë e Qershorit të takohen partnerët e identifikuar ku do të duhej të arrihet marrëveshja për koordinim dhe veprim të përbashkët të partnereve si janë; Operativa pranë St. Policore ,Drejtorit Komunale; si që është ai i Arsimit, Emergjencave, shëndetësisë, bujqësisë, ambientit dhe trafikut , forumet e Sigurisë si janë ;EVSB-të, KLSP-të si dhe KKSJ-ja , shoqëria civile, mediat.

- **Në javën e katërt** të Qershorit; Marrja e detyrave dhe përgjegjësi ligjore nga ana e partnerëve,
- Caktimi i ligjëruesve dhe formimi i ekipeve për veprim në teren.
- Përcaktimi i lokacioneve, shkollave, vendbanimeve duke përgatitur orar të saktë të veprimit dhe prezantimit të projektit.
- Shfrytëzimi i bazës ligjore për bashkëveprim profesional të partnerëve si dhe gjetja e trajnerëve për edukim dhe trajnim të qytetarëve.
- Përcaktimi i Grup-moshave të qytetarëve ku do të mbahen trajnimet.
- Partnerët marrin obligime për planifikimin dhe realizimin e detyrave të veta .
- Prezantimi i këtij Projekti para audiencës do të filloj : **Javen e parë të Korrikut dhe do te zgjas deri ne Javen e fundit te muajit Tetor 2021.**

5.5.3. Drejtoria e Policisë në Bashkësi dhe Parandalim në bashkëpunim me Divizionin e Komunikacionit Rrugor të përgatisin fletëpalosje vetëdijesuse për informimin e qytetarëve lidhur me dëmtimet e sinjalizimit horizontal dhe vertikal të trafikut, ndotjen e ambientit dhe dëmtimin e pronës shoqërore ne përgjithësi .

5.5.4. Njësit e angazhuara në implementimin e projektit:

- a) Drejtoria e Policimit në Bashkësi,
- b) Drejtoria për Parandalim në Komunikacionin Rrugor (DKRR),
- c) Stacionet Policore,**
- d) Njësit e Rajonale të Komunikacionit Rrugor,
- e) Njësia e Autostradës.

6. MEDIAT

6.1. Fletë palosja të shpërndahet në faqen zyrtare të PK-se me mesazhe vetëdijesimi për qytetarët lidhur me raportimin e dëmtimeve të pronave shoqërore (rrethojave, ndriçimit, shenjave të trafikut, mbishkrime tjera në mure etj). Aktivitetit të punës se përbashkët Polici-Komunitet ti epet rëndësi dhe plasim.

7. MONITORIMI

- 7.1 Drejtoria e Policisë në Bashkësi dhe Parandalim;
- 7.2 Divizioni i Komunikacionit Rrugor;
- 7.3 Sektori i operativës rajonale të DRP-ve;
- 7.4 Nga komandantët e stacioneve policore;
- 7.5 Njësive të Komunikacionit Rrugor.

8. RAPORTIMI

8.1. Në çdo muaj zyra operative e stacionit policor, do të raportoj te zyra e operativës Rajonale, pastaj nga zyra e operativës rajonale të përcjellë informacionet në Drejtorinë e Policisë në Bashkësi dhe Parandalim rreth numrit të takimeve dhe aktiviteteve me qytetar dhe me Forume të sigurisë.

- a. Operativa Rajonale të mbaj shënime në lidhje me dëmtimet rreth infrastrukturës rrugore, ndezjen e pyjeve apo fushave, dëmtimit/ngjyrosjen e mureve me grafitë të ndryshme, dëmtimet e parqeve etj.
- b. natyra e rastit(aksidentale apo e qëllimshme);
- c. numri i rasteve të iniciuara (raste penale dhe raste të kundërvajtjeve).

Raportimi përmes Formës Shtojcë 1

9. VLERËSIMI / VAZHDIMËSIA:

9.1. Pas analizave dhe statistikave mbi implementimin e projektit, këto aktivitete do të vazhdojnë në periudha kohore të ndryshme .



SEKTORI PËR KOORDINIM TË PROJEKTEVE Projekti "Ndërgjegjësimi ndaj Dëmtimeve të Pronës Shoqërore / Publike"	DREJTORA E POLICISË NË BASHKËSI DHE PARANDALIM
<p style="text-align: center;"><u>BARTËS TË PROJEKTIT</u></p> <p>Kapiten Begishe KRASNIQI Shef i Sektorit për Bashkëpunim me Forumet e Sigurisë</p> <p>Nënshkrimi _____ Data: _____</p> <p>Kapiten Driton Morina Shef i Sektorit për Bashkëpunim dhe Përkrahje në Komunikacionin Rrugor</p> <p>Nënshkrimi _____ Data: _____</p> <p>Ing.Lendita GASHI Zyrtare e Lartë e Infrastrukturës Rrugore Drejtoria për Parandalim në Komunikacionin Rrugor</p> <p>Nënshkrimi _____ Data: _____</p> <p>Partnerët bashkëpunues -Ministria e Infrastrukturës Rrugore - Drejtorit Komunale</p> <p>Përfituesit e projektit - Qytetarët</p>	<p style="text-align: center;"><u>APROVIMI I MBIKQYRËSVE</u></p> <p>N/Kolonel Afrim AHMETI Drejtor i Drejtorisë për Parandalim në Komunikacionin Rrugor</p> <p>Nënshkrimi _____ Data : _____</p> <p>N/Kolonel Arbnes AJVAZI Drejtor i Divizionit për Siguri Publike</p> <p>Nënshkrimi _____ Data : _____</p> <p>N/Kolonel Jeton REXHEPI Drejtor i Divizionit të Komunikacionit Rrugor</p> <p>Nënshkrimi _____ Data : _____</p>